



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.713/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesues, Milena Đerić dhe Kymete Kicaj anëtare, duke vendosur përkitazi me ankesën e Muhamet Kurtaj, kandidat për kuvend komunal nga Lëvizja Vetëvendosje në Komunën e Gllogocit të paraqitura kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me objekt të çështjes keqpërdorim i votave, ne Qendrën e Votimit 0307E në fshatin Abri e Epërme, në SHFMU “Shotë Galica”, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 22.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si e pasafatshme ankesa Anr.713/2021 e datës 21.10.2021, e paraqitur nga Muhamet Kurtaj, kandidat për kuvend komunal nga Lëvizja Vetëvendosje në Komunën e Gllogocit kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me objekt të çështjes keqpërdorim i votave, ne Qendrën e Votimit 0307E në fshatin Abri e Epërme, në SHFMU “Shotë Galica”, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021

A r s y e t i m

Me datë 21.10.2021, Muhamet Kurtaj, kandidat për kuvend komunal nga Lëvizja Vetëvendosje në Komunën e Gllogocit, me të cilën pretendon se ne Qendrën e Votimit 0307E në fshatin Abri e Epërme, në SHFMU “Shotë Galica” nuk përputhet numri i votave ngase numri i votave të tij është shumë më i madh, por sipas informatave të tij ka keqpërdorime dhe vjedhje të votave kryesisht nga vëzhguesit, njëherit bashkëshorti i kandidates po nga e njëjta parti ka bashkëpunuar me subjektet e tjera që të favorizohen kandidatët e tyre të caktuar. I njëjti pretendon se këtë bisedë e ka dëgjuar edhe djali i axhës së tij.

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmërisë së ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pasafatshme

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga Muhamet Kurtaj, kandidat për kuvend komunal nga Lëvizja Vetëvendosje në Komunën e Gllogocit, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën nenin 5 paragrafi 5 i rregullës 02/2015 “Rregullat dhe Procedurat” i cili përcakton se: *“Për të gjitha çështjet që nuk lidhen*

drejtpërdrejt me votimin dhe numërimin, ankesa duhet të parashtrohet pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga shkelja e supozuar”.

Në këtë kuptim nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rezulton se parashtruesi ankesën e ka paraqitur me datë 21.10.2021, ndërsa afati për paraqitjen e ankesës ka qenë njëzetekatër (24) orëve nga momenti kur ka ndodhur shkelja e supozuar në ankesë e ka qenë me datën 17.02.2021, që do të thotë se ankuesi, ankesën e ka parashtruar pas afatit të përcaktuar me nenin 5 paragrafi 5 i rregullës 02/2015 “Rregullat dhe Procedurat”.

Paneli pasi që vërtetoi faktin se ankesa e parashtruar nga Muhamet Kurtaj, kandidat për kuvend komunal nga Lëvizja Vetëvendosje në Komunën e Glllogocit, është e pasafatshme, i njëjti nuk u lëshua në vlerësimin e çështjes meritore.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 6 paragrafi 4 i rregullës 02/2015 “Rregullat dhe Procedurat, nenit 115 paragraf 1, dhe 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A.nr. 713/2021 me datë 22.10.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.